MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE BLLATË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën Doganore Bllatë me objekt "Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor" dhe për auditimin e insititucionit për vitin 2009 dhe 2010. Masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.28, datë 05/03/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 368/6, datë 05/03/2012 dërguar Z. Premtim Kryemadhi, Kryetar i Degës Doganore Bllatë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Të analizojë me të gjithë stafin Raportin Përfundimtar të Kontrollit në të cilin janë paraqitur rast pas rasti shkeljet e konstatuara, njëkohësisht të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara bashkëlidhur këtij raporti.

Menjëherë

2. Të merren masa për ndjekjen e subjekteve debitorë, lidhur me borxhin doganor të lindur, duke zbatuar proçedurat ligjore deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara për vlerën 40.078.382 lekë.

Menjëherë

3. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të verifikohen faturat e importit të artikujve elektroshtëpiakë me origjinë nga Sllovenia, ku distributori është në Prishtinë, për vitet 2006, 2007 e vazhdim, me qëllim saktësimin e detyrimeve doganore për dy subjekte

Menjëherë

4. Në bashkpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren masat ligjore për rikuperimin e borxhit, për arsye të mospagesës së taksës prej 7 %, të vlerës për ekzekutimin e vendimit nga zyra e Përmbarimit për një subjekt privat

Menjëherë

B. Masa Zhdëmtimi

1. Të saktësohen, kontabilizohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për detyrimet doganore të rezultuara të pallogaritura në zhdoganinim e artikujve të ndryshëm për detyrat e mëparshme të pa realizuara, paraqitur me shkresën nr. 160/5 prot, datë 28.08.2008. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të përcaktojë drejt koeficientët e vjetërsisë së automjeteve të përdorura sipas viteve sidomos për vitin 2006, me qëllim saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit doganor të papaguar në vlerë 363,922 lekë për gjashtë subjekte privatë

Deri më datë 31.12.2012

2. Me qëllim saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të papaguar në një vlerë prej 642,911 lekë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe në zbatim të udhëzimeve të vlerës, në mënyrë të vazhdueshme të aktivizojë komisionin e vlerës, i cili për çdo verifikim të hartojë proçesverbale lidhur me mënyrën e përcaktimit të vlerës së pranuar për artikujt e përdorur, verifikimin e tyre në origjinë, të cilat japin efekt në llogaritjen e detyrimeve doganore si rezultat i përdorimit të koeficientëve të ndryshëm në llogaritjen e vlerës, për një subjekt privat

Menjëherë

3. Të saktësohen, kontabilizohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për detyrimet doganore të rezultuara të pallogaritura në zhdoganinim e artikujve të ndryshëm me efekt në vlerë 3,668,109 lekë për shtatëmbëdhjetë subjekte privatë.

Deri më 31.03.2012

C. Masa Disiplinore

Mbështetur në nenin 25 të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.306,datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë proçedurat për dhënien e masës disiplinore:

1. “Largim nga shërbimi civil”, neni 25, pika 3, gërma d, për një punonjës për moszbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga kontrolli i mëparshëm, që bie në kundërshtim me Ligjin Nr.8270 dat 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet në Ligjin Nr. 8599, datë 01.06.2000, ku përcaktohet, Neni 16, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë;
   i. të kërkojë nga subjektet e kontrolluara marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes në përputhje me rekomandimet e kontrollit;
   ii. të kërkojë nga subjektet e kontrolluara ose nga autoritetet më të larta shtetërore marrjen e masave të zhdëmtimit dhe disiplinore në përputhje me ligjet përkatëse ndaj personave që kanë shkaktuar dëme direkte ose indirekte;
   iii. të njoftohet për kërkesat e bëra, sipas paragrafit të mësipërm, nga subjektet e kontrolluara brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.
2. “Pezullimi nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë 6 mujore”, neni 25, pika 3, gërma c, për tetë punonjës për klasifikim të gabuar doganor

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit z. Neritan Matoshi, përgjegjës grupi, z. Përparim Gjuzi dhe anëtar, z. Jeras Poçi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj, Drejtori i Departamentit z. Aleksandër Lipivani dhe Drejtori i Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.